BalkanWeb | GAZETA SHQIPTARE

100% SHIJE ME ËMBËLSUES NGA BIMA E STEVIAS 0% SHEQER 0% KALORI
ZGJIDH ANËN "GREEN" TË COLA

U plagos gjatë tentativës për t'u larguar, "arrest me burg" për Orges Bilbilin. Ja akuzat kundër tij

12 Prill, 2020 13:13 |



Madhësia e tekstit: ⊖ ⊕

Gjykata e Tiranës ka caktuar masën e siguriseë "arrest me burg" për Orges Bilbilin, i cili kanosi një polic gjatë ditës së djeshme në kryeqytet.

FATURA?

Masa e sigurisë ndaj Bilbilit u dha nga prokurori Petrit Hysi, kurse gjyqtar i cështjes ishte Kujtim Vranici.

Gazetarja Klodiana Lala raporton për "Balkanweb" se Bilbili akuzohet për "vrasje e mbetur në tentativë" dhe "armëmbajtje pa leje".

Masa e sigurisë ndaj Bilbilit u dha tek Spitali i Traumës, ku ai ndodhet i shtruar.

Cfarë ndodhi dje, gjithë skema e ngjarjes

Nga hetimet policia ka zbuluar se 30-vjeçari nga Lushnja i akuzuar për vrasje që mbeti i plagosur pasi tentoi të ngrinte armën ndaj një efektivi policie jetonte në një apartament në rrugën "Sitki Çiço" me qira prej disa muajsh. Apartamentin e ndante me një djalë tjetër i cili nuk është identifikuar ende nga policia. Ditën e djeshme, kur ndodhi ngjarja ata kanë qenë në rrugë të dy, por personi tjetër u largua në drejtim të paditur. Policia e Tiranës ushtroi kontroll në këtë banesë dhe gjeti një arme zjarri dhe një sasi të konsiderueshme parash.

Grupi hetimor i ngritur për ngjarjen ka rindërtuar skenën e plagosjes së Orges Bilbilit dhe kalimtares.

Dëshmia e punonjësit të policisë është përputhur me pamjet e kamerave të sigurisë në zonë të cilat u sekuestruan. Ngjarja u shënua në orën 11:35 ku efektivi i "Shqiponjave" iu afrua Orges Bilbilit i cili ishte duke lëvizur më këmbë në brendësi të lagjes në rrugën "Sitki Çiço" ndërsa kolegu i tij ishte duke kontrolluar lulishten para Maternitetit të Ri. Në brendësi të lagjes punonjësi i Shqiponjave konstatoi Orges Bilbilin së bashku me një person tjetër dhe u afrua për të komunikuar me ta, për të mësuar arsyen e daljes dhe për t'i identifikuar por Bilbili e kundërshtoi dhe iku me vrap.

Polici fillon ta ndjekë dhe në momentin kur ishin para shkollës "Niket Dardani" Orges Bilbili në ecje e sipër nxori pistoletën nga çanta marsup, por pistoleta iu rrëzua në tokë. Në këto momente punonjësi i policisë qëlloi në ajër për ta paralajmëruar.

Bilbili mori pistoletën nga toka dhe ia drejtoi policit. Ky i fundit hapi zjarr në drejtim të Bilbilit dhe e plagosi. Nga 3 të shtënat në drejtim të Bilbilit një prej plumbave ka kapur edhe 30-vjeçaren me iniciale M. P. e cila po kalonte rastësisht aty.

Kush është Orges Bilbili?

30-vjeçari nga Lushnja Orges Bilbili ka arritur t'u shpëtojë 14 operacioneve policore që janë ndërmarrë për arrestimin e tij. Ai akuzohet për një vrasje të dyfishtë dhe ishte në listën e personave të kërkuar nga Policia shqiptare i dënuar në mungesë me 7.4 vjet heqje lirie.

Bilbili akuzohet për vrasjen në vitin 2017 të shtetasve Jurgen Hoxha dhe Zamir Latifi, të cilët njihen si miqtë e ngushtë të Xhulio Shkurtit, djali i vëllait të Aldo Bares (Alfred Shkurtit).

Ky i fundit mbeti i plagosur me 25 shtator të vitit 2016 së bashku me shokun e tij Saimo Xheliu, 25 vjeç në të njëjtën zonë ku ndodhi ngjarja e djeshme.

Për ngjarjen e vitit 2016, ku mbetën të plagosur Shkurti dhe Xheliu nuk u arrestua asnjë person ndërsa i dyshuari kryesor nga policia ishte Laert Haxhiu 25 vjeç. Ky i fundit dyshohet se bashkë me Orges Bilbilin kanë vrarë shokun e Aldo Bares, Gerti Lala i njohur me nofkën "Iriqi" në vitin 2009.

Ndërkohë nga Policia e Qarkut Fier u pohua se për ngritjen e akuzës ndaj tij ka ndihmuar e ëma e viktimes e cila njohu 20-vjecarin Bilbili si vrasësin e të birit.

Orges Bilbili është dënuar me 7. 4 vjet burgim për trafikim lëndësh narkotike dhe është shpallur nga policia person në kërkim si bashkëpunëtor i pilotit italian Giorgio Riformato për drogën e Divjakës.

(Balkanweb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

" Lëre të lirë se i shërben qeverisë në zgjedhje", Salianji: Orges Bilbili u kap rastësisht nga një polic që nuk kishte kohë të telefononte shefin, ja çfarë mund t'i thoshte ai

Arrestimi i Orges Bilbilit, Ardi Veliu: Policit iu drejtua arma, bëri detyrën me profesionalizëm dhe e qëlloi më shpejt

I shpëtoi policisë, zbulohet shoku i Orges Bilbilit, gazetarja Lala: Efektivi i "Shqiponjave" meriton respektin e të gjithëve

EKSKLUZIVE/ "Isha në radhë për të bërë pazarin", flet vajza që u plagos tek "Xhamlliku": Pashë gjithçka. Jam qëlluar dy herë, kam shumë dhimbje

U plagos nga polici, Orges Bilbili 'kyç' gojën. Hetimet i zbulojnë banesën ku jetonte prej disa muajsh. E gjithë skema e ngjarjes

U plagos rastësisht në kapjen e Orges Bilbilit, Lleshaj viziton qytetaren në spital: I kërkuam ndjesë, është jashtë rrezikut për jetën

VIDEO/ U plagos aksidentalisht pasi efektivi qëlloi ndaj vrasësit për ta neutralizuar, momenti kur makina e policisë transporton vajzën në spital

Dinamika/ Vrasësi në kërkim u plagos nga efektivi, reagon policia: Si ndodhi ngjarja

VIDEO/ Si u plagos vrasësi nga Lushnja, drejtori i Policisë së Tiranës tregon dinamikën e ngjarjes

U plagos nga polici gjatë tentativës për t'u arratisur, kush është vrasësi nga Lushnja që ishte në kërkim (EMRI)

E rëndë në Tiranë/ Nuk iu bind urdhrit për t'u identifikuar dhe kërcënoi policin me armë, plumb në këmbë personit të rrezikshëm. Plagoset aksidentalisht këmbësorja

Etiketa: arrest me burg orges bilbili Tirane

BW Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu


SHKARKO & REGJISTROHU NË MY TELEKOM APP +3GB DHURATË

#MOSDILNGASHTEPIA shop.shpresa.al



LAJMET E FUNDIT


Trump dha urdhër për ndërprerjen e fondeve, reagon OBSH: Na vjen keq për vendimin, do punojmë me partnerët për cdo boshllëk
15 Prill, 2020


Bregasi: Korniza e rregullave të lëvizjes duhet të jetë më e qartë. Frymë optimizmi dhe jo bllokim biznesit
15 Prill, 2020


Belgjika zgjat bllokimin deri më 3 maj
15 Prill, 2020

Koronavirusi godet frikshëm Kosovën, konfirmohen 36 raste të reja, shkon në 423 numri i të infektuarve
15 Prill, 2020


"Qeveria të përgatitet për borxhin", Petrit Ago: Minimumi situata post-pandemi do zgjasë 12- 18 muaj, nëse nuk suportohen sektorët kyçë do jetë situatë kritike
15 Prill, 2020

Aksident tragjik në Shijak, humb kontrollin e motorit, vdes 43-vjecari
15 Prill, 2020

DREJT Korça e në shtëpinë tuaj! POROSIT NE TELEFON! DERGESA FALAS! PAGUAJ KESH! +355 68 609 4104 (WHATS APP & SMS)

DREJT fab e në shtëpinë tuaj! POROSIT NË TELEFON! DËRGESA FALAS! PAGUAJ KESH! +355 68 609 4104 (WHATS APP & SMS) 0,5L Sasia minimale 3 Koli (36 Copë)

HYSENBELLIU GROUP

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE
@balkanweb

TË NGJASHME


Vdekja tragjike e të riut në Tiranë, rrëqeth i ati: Ja ç'më tha para se të ikte për të blerë domate, nuk e pamë në spital
15 Prill, 2020

EMRAT/ Grabitën lëkurë tapicerie gjatë pandemisë, "arrest me burg" për dy të arrestuarit
15 Prill, 2020

Shfaq Komentet (2)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Aksident tragjik në Shijak, humb kontrollin e motorit, vdes 43-vjecari
15 Prill, 2020

15 Prill, 2020
"Ma bënë me hile kolegët", Brataj tregon si e luftoi COVID-19, qetëson qytetarët: Pasojat e virusit janë "fryrë", nuk vdes çdo person që preket

Mposhti koronavirusin, Skënder Brataj i Urgjencës: Ja kur do të rikthehem në punë
15 Prill, 2020

AKEP urdhëron kompanitë e internetit: Bllokoni faqet me përmbajtje pornografike
15 Prill, 2020


Ish i dënuari për trafik droge e pëson sërish, policia i gjen armë në makinë pas kontrollit në Golem
15 Prill, 2020

VIDEO/ I biri dha alarmin, gjendet e pajetë në banesë e moshuara nga Elbasani, policia hyn nga dritarja
15 Prill, 2020

KATEGORIA VIDEO

VIDEO/ Dhurata Çupi: Situatë migjeniane në Klos, blerjet me listë janë dyfishuar si pasojë e COVID 19
15 Prill, 2020

Banorët lënë 'peng' emrin/ Tregtarët e ushqimoreve në zonat rurale në Mat në vështirësi, 40% e fshatit blejnë me listë
Enver Doçi | 15 Prill, 2020

E pabesueshme në kohë izolimi/ Endacaku udhëton nga Tirana drejtim të Dibrës në këmbë për 2 ditë: Nuk më ndali askush në rrugë
15 Prill, 2020

Tave me perime dhe sallam fshati dhe torte me krem vanilje dhe luleshtrydhe
15 Prill, 2020

Veliaj dhe ambasadori italian Fabrizio Bucci dhurojnë gjak për njerëzit në nevojë: Një detyrë qytetare
15 Prill, 2020

"Epidemiologët pa njohur orare, gjurmojnë çdo ditë rastet në terren", Manastirliu: T'i japim dorën profesionistëve për të luftuar COVID-19
15 Prill, 2020

BalkanWeb

FAQET ZYRTARE
News24
Gazeta Shqiptare
Radio RASH

PRIVATËSIA
POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT
redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24
Alert
Emisioni Chic
Emisioni Diplomaticus
Emisioni Vila 24
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Monitor Ekonomi
Real Story
Shqiptarët për shqiptarët
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI
Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA
New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

© 2020 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.